



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

2861

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Roskovec, më 16, 04, 2026

Lënda : Raport për dëgjesat publike të zhvilluara në datën 14 Prill 2026

**KRYETARIT TË BASHKISË**

**Znj.Majlinda Bufi**

**Këtu**

Në bazë të ligjit Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 18; ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, shkresës me Nr.2159 prot. datë 18.03.2026 “Njoftim për dëgjesat publike” ju bëj me dije si më poshtë:

Në bazë të njoftimit me Nr.2159 prot. datë 18.03.2026 në lidhje me zhvillimin e dy dëgjesave publike me temë “Për një shtesë në paketën fiskale për vitin 2026”, u zhvilluan dy dëgjesa sipas përcaktimeve në njoftimin përkatës dhe konkretisht :

Në datën 14.04.2026, ora 14<sup>00</sup>, u zhvillua dëgjesa publike me banorë dhe grupe interesi, pranë Njesisë Administrative Strum, fshati Suk 2.

Në datën 14.04.2026, ora 15<sup>00</sup>, u zhvillua dëgjesa publike me banorë dhe grupe interesi, në qytetin Roskovec, në sallën e Këshillit Bashkiak.

Këto dëgjesa u zhvilluan në bashkëpunim të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak ku pjesë e takimeve ishin Nënkryetari M.Goga, Drejtori i të Ardhurave Vendore S.Çepele, Sp.e të Ardhurave Vendore Xh.Sakaj, Kryetari i Këshillit A.Plaka, këshilltarët L.Goga, F.Hoxha Sekretare e Këshillit A.Hajdini, Administratori dhe kryetarët e fshatrave të Njesisë Strum, kryetari i fshatit Jagodinë si edhe qytetarë përkatësisht: 32 meshkuj dhe 9 femra.

Gjithashtu në këto dëgjesa morën pjesë dhe përfaqësues të kompanisë GENER 2, si palë të interesuara.

Banorët pjesëmarrës në këto dëgjesa nuk shprehën kundërshtim në lidhje me materialin e prezantuar nga stafi i Bashkisë. Përfaqësuesi i kompanisë GENER 2, z.Noel Vata u shpreh se parimisht janë dakort dhe janë të detyruar në kuptimin e mirë të fjalës që të zbatojnë propozimet, ligjet dhe rregullat e Bashkisë në të cilën po bëhet investimi. Z.Vata u shpreh gjithashtu se

mbledhjen dhe largimin e mbeturinave e bën vet kompania, dhe duke qënë se ai ishte me detyrë Inxhinieri i kompanisë, kërkoi edhe pak më tepër kohë për ta shqyrtuar materialin me Ekonomistin e kompanisë. Në lidhje me kërkesën e bërë nga z.Vata për të marr pak më tepër kohë për të shqyrtuar materialin, nga stafi i Bashkisë u pranua kërkesa dhe iu la kohë deri para datës 25 Prill për të dërguar në një nga dy imeilet e vendosura në dispozicion, mendimet apo sugjerimet e tyre në rast se do kishin.

Gjatë takimeve është mbajtur procesverbal, foto dhe listëprezecedë për të pranishmit.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin !

*Sekretar i Këshillit*  
*Arlinda Hajdini*

